REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

**PROJEKTI FITUES ME TITULL:**

# “ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS NË SHËRBIM TË FUQIZIMIT TË KËRKUESËVE TË RINJ DHE TË STUDENTËVE”

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**


**Ekipi i projektit:**
Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA (koordinatore)
Prof. Asoc. Dr. Anida KISI
Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI
Prof. Asoc. Dr. Etleva KONDI
Dr. Elvana SHTËPANI

**Vijimi i fazën së parë të projektit:**

## TRAJNIM I PERSONELIT AKADEMIK
## PËR PËRDORIMIN E PAISJEVE ELEKTRONIKE DHE SOFTWAREVE
## TË INSTALUAR NE LABORATORËT E RINJ

Pas përfundimit të punimeve për ngritjen e infrastrukturës kërkimore-shkencore, ekipi i didaktikës dhe teknologjisë u organizua për trajnimin e personelit akademik në përdorimin e paisjeve të reja elektronike dhe softwarëve të instaluar në Laboratorët e rinj në funksion të mësimdhënies.

Me mbështetjen e personelit të Degës së Teknologjisë së Informacionit (IT) në FGJH u përpilua programi i trajnimi dhe një kalendar për të gjithë personelin akademik të ndarë sipas departamenteve si edhe për studentët e programit të ciklit të tretë doktoral.












Gjithashtu me anë të bashkëpunimeve të krijuara me universitete të mirënjohura në Evropë, u sigurua një trajnim online me temë: "*Trajnim mbi përdorimin e programit GOLD dhe mësimit digjital të lëndës së didaktikës*" me operatorin spanjoll që ka krijuar aplikacionin/programin Gold, në të cilin morën pjesë online anëtarë të personelit akademik të FGJH, UT-së.



Personeli i Degës së Teknologjisë dhe Informacionit në mënyrë të vazhdueshme jep kontributin profesional në rritjen e kapaciteteve digjitale të personelit akademik dhe studentëve të Fakultetit duke zhvilluar trajnime mbi përdorimin e mjeteve digjitale në laboratorët e rinj.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA E TRAJNIMEVE DHE INOVACIONIT PEDAGOGJIK

Kalendari i Trajnimeve të Studentëve për vitin akademik 2023-2024

Trajnimet zhvillohen në auditor dhe online

| Nr | Data | Ora | Temat e Trajnimit |
|---|---|---|---|
| 1 | 09.10.2023 | 13:30-15:30 | Paisja me emailin zyrtar dhe vënia e tij në përdorim (për vitin e parë) Informimi mbi përdorimin e sistemit informatik, e-Student. |
| 2 | 16.10.2023 | 13:30-15:30 | Njohja dhe përdorimi i aplikacioneve të inteligjencës artificiale (AI) Përdorimi i ChatGPT për qëllime didaktike. |
| 3 | 06.11.2023<br>07.11.2023 | 13:30-15:30<br>13:30-15:30 | Teknikat e menaxhimit të kohës dhe praktikat produktive në marrjen e shënimeve në auditor. |
| 4 | 04.12.2023<br>05.12.2023 | 13:30-15:30<br>13:30-15:30 | Zhvillimi i aftësive të shkrimit akademik duke i ndihmuar studentët të zhvillojnë një përvojë të suksesshme në mësimnxënie dhe hulumtim. |
| 5 | 11.01.2024 | 13:30-15:30 | Menaxhimi i stresit: Teknikat për ta trajtuar dhe menaxhuar duke përfshirë teknika të qetësimit dhe mënyra për të ruajtur mirëqenien emocionale. |
| 6 | 12.02.2024<br>13.02.2024 | 13:30-15:30<br>13:30-15:30 | Qasja në mësimdhënie me projekte dhe zgjidhja e problemeve. |
| 7 | 19.02.2024 | 13:30-15-30 | Ndërtimi i marrëdhënieve dhe aftësive sociale për ndërveprimin dhe bashkëveprimin në një mjedis social dhe profesional. |
| 8 | 04.03.2024 | 13:30-15-30 | Planifikimi i karrierës, zhvillimi dhe ndërtimi i rrjetit të kontakteve. |
| 9 | 03.04.2024 | 13:30-15:30 | Teknika të komunikimit për ndërveprim profesional. |
| 10 | 22.04.2024 | 13:30-15:30 | Menaxhimi i financave personale dhe arti i investimeve. |
| 11 | 02.05.2024 | 13:30-15:30 | Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies. |






